



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 13.5.2015, ora 14,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Murat Hoxha, Haxhi Shala.

Munguan : Lahi Brahimaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.4.2015,
3. Shqyrtimi i raportit vjetor nga Zyra rregullatore për ujësjellës dhe kanalizim,
4. Shqyrtimi i raportit vjetor nga Agjencia për menaxhimin e komplekseve memoriale,
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.4.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor nga ZRRUK

Kryetari përshëndeti anëtarët e komisionit dhe i ftoi zyrtarët nga zyra rregullatore të prezantojnë me raportin vjetor, mirëpo në ndërkohë ndërhyri **Shaip Muja** duke konstatuar jo ligjshmërinë e raportimit nga ushtruesi i detyrës së drejtorit në këtë zyre. Pas leximit të shkresës së sekretarisë nga ana e kryetarit **Fikrim Damka** rreth organeve të pavarura që kanë mbetur pa borde apo

udhëheqës, komisioni megjithatë nuk pranoi të procedohet me një raportim vjetor nga zyrtar jo kompetent dhe u shty për një ditë tjetër ky raportim derisa konsolidohen organet e pavarura, përkatësisht kur të kompletohet kjo zyre me udhëheqës kompetent dhe të zgjedhur në mënyrë ligjore.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor nga Agjencia e komplekseve memoriale

Kryetari përshëndeti drejtorin e agjencisë **Idriz Blakaj** të cilit ja dha fjalën. Ai njoftoi komisionin se kjo agjenci ende në konsolidim e sipër, me mjaft vështirësi po përparon duke pasur pengesa të ndryshme, fillimisht me mosbartjen e projekteve nga MMPH e deri te problemet tjera teknike, administrative dhe buxhetore. Kjo agjenci tani për tani menaxhon me një kompleks (të Adem Jasharit) për të cilin janë duke bërë angazhimet rreth sjelljes së ujit për gjelbërim nga Ujmani ndërkaq përpjekja për dy ciceronë më në fund është lejuar, ai sjelli fakte komisionit edhe për çështje tjera të cekura në raportin me shkrim dhe kërkoi ndihmën e këtij komisioni si themeluese e agjencisë për të ndihmuar në konsolidimin e kësaj agjencie përmes bashkëpunimit, sidomos me hartimin e ligjit të ri që tanimë ka filluar GP. **Fikrim Damka** njoftoi drejtorin rreth kërkesës së agjencisë për bartjen e projekteve, për çka MMPH ka deklaruar se ato do të barten por gradualisht me përfundimin e secilit veq e veq dmth ato që nuk kanë filluar do të barten agjencisë, ato që nuk kanë përfunduar duhet të përfundojnë në MMPH. **Murat Hoxha** konstatoi se me gjithë përpjekjet e mëdha kjo agjenci e re kërkon ndihmë dhe bazë më të gjerë ligjore dhe jo vetëm me menaxhua vetëm me një kompleks, ndaj kërkoi nga zyrtarët e agjencisë të hartojnë planin e punës dhe të drejtojnë Qeverisë atë. **Shaip Muja** theksoi rregullsinë e kërkesave të agjencisë mirëpo gjithashtu kërkoi edhe involvimin e komunës në kryerjen e detyrave të kësaj agjencie, ngase e vetme nuk mundet të përballoi të gjitha obligimet, sidomos rreth mirëmbajtjeve të komplekseve nëpër komunat e ndryshme. Me ligj duhet të precizohet çka i takon agjencisë e çka komunave. Rreth mirëmbajtjes së busteve (fshirja, larja etj) kishte polemika me z. Adem Salihaj, mirëpo të dy u pajtuan se figurat e mëdha (bustet) duhet të respektohen nga të gjithë. **Adem Salihaj** arsyetoi kërkesat e drejtorit të agjencisë por konstatoi se kësaj agjencie i duhet edhe një kohë deri në konsolidim ngase është në themelim, zyrtarët e agjencisë, vazhdoi, duhet të zgjerojnë listën e komplekseve, madje edhe ato private të ndërtuara nga familjet e ndryshme të dëshmorëve, ti sugjerojnë Qeverisë një organogram dhe plan të ri të figurave të mëdha, në mënyrë që ajo të inkorporoj ato në kompetencat e agjencisë, potencoi Ferizajin për mirëmbajtjen e komplekseve. **Idriz Blakaj** potencoi se të gjitha këto që u cekën, ai ka kërkuar dhe do të precizohet me ligjin e ri çka kujt i takon, sidomos shtoi se projektet e pa bartura nga MMPH janë pjesë e ligjit të miratuar nga ky Kuvend, ndaj MMPH bënë shkelje ligjore ose si tha ai “unë nuk jam diçka në rregull”. Ju duhet të bëni presion MMPH-së, ngase ky komision e ka hartuar ligjin, përfundoi ai. Edhe **Salih Salihu** u pajtua që ligji ri duhet të precizoi kompetencat se kush për çka ka obligime.

KOMISIONI MIRATOI raportin vjetor të agjencisë për vitin 2014 i cili do të përcjellët Kuvendit për miratim.

5...Të ndryshme

Ashtu si është sugjeruar në mbledhjen e fundit të komisionit, komisioni vazhdoi me analizën e rekomandimeve të propozuara për cilësinë e grurit të importuar, ndaj pasi që u përmirësua rekomandimi i parë, i dytë dhe i tretë, dhe pasi u sugjerua të përfshihet një rekomandim nga Shaip Muja, mbledhja u ndërpre për shkak të mungesës së kuorumit. Mbledhja do të mbahet të martën në orën 13,00.

Mbledhja përfundoi në orën 15,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka